



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar”, shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në cilësinë e deputetit.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

K R Y E T A R I

Lulzim Basha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ
Nr. _____/2023

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN 9049, DATË 10.04.2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR”,

Në mbështetje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet nga “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” në “Për luftën kundër korrupsionit, deklarimin e interesave private dhe kontrollin e figurës”.

Neni 2

Kudo në tekstin e ligjit fjalët “Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit” dhe “ILDKPP” zëvendësohen me fjalën “Autoriteti”

Kudo në tekstin e ligjit fjalët “Inspektori i Përgjithshëm” zëvendësohen me fjalët “Anëtar i Autoritetit” ose “Autoriteti”.

Kudo në tekstin e ligjit paragrafët pa numër numërtohen.

Neni 3

Neni 1 riformulohet si vijon: “1. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i integritetit të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë, në drejtim të pasurisë dhe figurës përmes procesit të deklarimit dhe kontrollit. 2. Procesi i kontrollit të integritetit synon mbrojtjen dhe garantimin e funksionimit demokratik të Kuvendit, Këshillit të Ministrave, organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura kushtetuese nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i funksionarëve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar

Neni 4

Pas nenit 1, shtohet neni 1/1 me përmbajtjen si vijon: “Neni 1/1, Objekti. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e: a) pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj,

detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta; b) rrethanave që cenojnë figurën e të zgjedhurit dhe funksionarit kushtetues.

Neni 5

Në nenit 2 shtohet pikat:

“11. “Kontakt i papërshtatshëm” është kontakti me persona të përfshirë në krimin e organizuar.”

“12. “Autoriteti” është Autoriteti për luftën kundër korrupsionit, kontrollit të interesave private dhe figures, me akronimin ALK

“13. “Deklarim” është deklarimi i pasurisë, interesave privatë, kontakteve të papërshtatshme dhe konfliktit të interesave.

Neni 6

Në nenin 3 bëhen shtesat si vijon

Në gjurmën a të pikës 1, pas fjalëve “...ministrat e zëvendësministrat” shtohen fjalët “dhe kryetarët e partive politike”.

Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2 me përmbajtje si më poshtë:

“4. Mbarin detyrimin për deklarimin periodik të figurës në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Integritetit: a) Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat dhe kryetarët e partive politike; b) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Figurës; c) prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe kryetarët e këshillave bashkiak; ç) Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj; d) Kandidatët për funksionet e mësipërme”

Neni 7

Në nenin 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1 pas fjalëve “dhe të detyrimeve financiare” shtohen fjalët “dhe kontaktet e papërshtatshme”.

Në pikën 1 pas gjurmës h) shtohet gjurma i) me këtë përmbajtje: “kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhjet me ta, ose shkaqet e kërtyre kontakteve”.

Neni 8

Neni 5 riformulohet si më poshtë:

- 1. Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit ose të të drejtës së kandidimit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. Autoriteti, brenda 30 ditëve, i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për largimin nga puna të personit që refuzon të deklarojë. Organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna të punonjësit që ka refuzuar deklarimin.*
- 2. Kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur Autoriteti vë në dijeni Kuvendin dhe, kur është rasti, edhe organin epror të personit.*
- 3. Kur deklarimi refuzohet nga persona të cilët kandidojnë për deputet dhe kryetar bashkie Autoriteti vë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe subjektin politik që ka propozuar kandidatin. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit i kërkon subjektit propozues zëvendësimin e kandidatit ose çregjistrimin e tij.*
- 4. Në të gjitha rastet e refuzimit të deklarimit, me kalimin e 30 ditëve nga njoftimi i organit përgjegjës, Autoriteti detyrohet të bëjë publike rastet e refuzimit të deklarimit.*

Neni 9

Në nenin 5/1 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në titullin e nenit hiqen fjalët “*të punës*”.

Në pikën 1 pas fjalëve “*...të punës*” shtohen fjalët “*apo të kandidimit*”.

Pas gërmës b) të pikës 1 shtohet gërma c) me këtë përmbajtje: “*c. kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhjet me ta, ose shkaqet e kërtyre kontakteve*”

Në pikën 2 pas fjalëve “*...data e fillimit të detyrës*” shtohen fjalët “*ndërsa deklarimi në rastin e kandidimit dorëzohet së bashku me dokumentacionin e regjistrimit të kandidatit por jo më vonë se 15 ditë nga dita e regjistrimit të kandidatit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.*”

Neni 10

Në nenin 7 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1, në fund të pikës, pas fjalëve “*...bëhet deklarimin*” shtohen fjalët “*si dhe cdo kontakt me persona të papërshtatshëm i ndodhur gjatë vitit të deklarimit*”.

Neni 11

Në nenin 7/1 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 2, në fund të pikës, pas fjalëve “*...largimit nga funksioni*” shtohen fjalët “*si dhe cdo kontakt me persona të papërshtatshëm i ndodhur gjatë të njëjtës periudhë*”.

Neni 12

Në nenin 9 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1 pas fjalëve “*...të kërkojë deklarimin*” hiqen fjalët “*e pasurive e të interesave private dhe burimin e krijimit të tyre*”.

Neni 13

Në nenin 9/1 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Bëhet numërtimi i paragrafëve.

Në paragrafin e parë (pika 1 pas numërtimit), pas fjalës “*Deklarimi*” hiqen fjalët “*i pasurisë dhe i interesave private*”.

Paragrafi i dytë (pika 2 pas numërtimit) ndryshohet si vijon: “*2. Në rastet e mosdhënies së autorizimit brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit për deklarim zbatohen parashikimet e nenit 5 të këtij ligji*”.

Neni 14

Pas neni 9/1 shtohet neni 9/2 me përmbajtje si vijon: “*Neni 9/2 Kontrolli me kërkesë 1. Kontrolli i integritetit për subjektet e parashikuara nga neni 3 pika 4 i këtij ligji, kryhet sa herë kjo kërkohet nga 7 deputetë, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i SPAK, si dhe nga jo më pak se 500 shtetas me të drejtë vote. 2. Kërkesa për kontroll duhet të përmbajë të dhëna, fakte apo rrethana specifike. Mungesa e tyre, në çdo rast, nuk pengon fillimin e kontrollit, sipas këtij ligji. 3. Çdo nismëtar i kërkesës gjobitet me 100 000 lekë kur pas kryerjes së kontrollit, kërkesa dukshëm është kryer me të dhëna të pavërteta. 4. Të drejtën për të bërë kërkesën për kontroll paraprak të kandidaturave në zgjedhje apo organe kushtetuese e ka edhe një parti politike për kandidatë të mundshëm të saj. Kjo kërkesë bëhet edhe jashtë periudhës zgjedhore dhe vetëm me pëlqimin e shtetasit, subjekt i verifikimit. Formulari i kërkesës hartohet sipas shtojcës bashkëngjitur ligjit dhe nënshkruhet nga kryetari i partisë apo një person i autorizuar prej tij, si dhe nga personi, subjekt i verifikimit. Kërkesa dorëzohet Autoritet e shoqëruar me formularin përkatës. Rezultati i kontrollit i komunikohet nga Autoriteti vetëm partisë politike që ka bërë kërkesën dhe personit të kontrolluar*”.

Neni 15

Emërtimi i Kreu II ndryshohet në “*Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit për Luftën Kundër Korrupsionit*”

Neni 16

Neni 11 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 11 - Autoriteti për luftën kundër korrupsionit

- 1. Autoriteti për luftën kundër korrupsionit është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për zbatimin e këtij ligji për administrimin dhe kontrollin e deklarimit të pasurisë, kontrollit të figurës, konfliktit të interesave dhe interesave privatë.*
- 2. Autoriteti ka seli në Tiranë dhe financohet nga buxheti i shtetit.*
- 3. Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloren e funksionimit, që miratohet prej tij.*
- 4. Autoriteti i kryen funksionet e tij, të përcaktuara në këtë ligj, në mënyrë kolegjiale. Legjislacioni në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale dhe Kodi i Procedurave Administrative zbatohet për aq sa është e mundur në funksionimin e Autoritetit”.*

Neni 17

Neni 12 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 12 - Përbërja e Autoritetit, zgjedhja dhe mandate i anëtarëve të tij

- 1. Autoriteti përbëhet nga 5 anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi, me shumicë të cilësuar prej tre te pestash të votave.*
- 2. Mandati i anëtarit të Autoritetit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.*
- 3. Kuvendi zgjedh një kryetar nga radhët e anëtarëve të Autoritetit.*
- 4. Anëtari i Autoritetit, të cilit i ka mbaruar mandati, qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij.”*

Neni 18

Neni 13 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Neni 13 - Kushtet për tu zgjedhur anëtar

1. Anëtar i Autoritetit mund të zgjidhet personi që:

- a. ka shtetësi shqiptare;*
 - b. ka zotësi të plotë për të vepruar;*
 - c. ka mbaruar arsimin e lartë, me Diplomë “Master shkencor”, ose tituj të ekuivalentuar me të, në fushën juridike ose ekonomike;*
 - ç. gëzon integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;*
 - d. ka jo më pak se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit;*
 - dh. nuk ka qenë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;*
 - e. nuk është anëtar në parti politike;*
 - ë. nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish- Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Interni-meve, hetues, prokuror ose gjyqtar në procese politike, dëshmitar i akuzës në proceset politike, të posaçme, apo denoncues;*
 - f. nuk ka konflikt interesi me detyrën;*
 - g. plotëson kushtet, kriteret dhe pajiset me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.*
- 2. Çdo kandidat për anëtar, përpara emërimit të tij, nënshkruan një deklaratë për mosmbajtjen prej tij të asnjë prej detyrave apo cilësive të përcaktuara në shkronjën “ë”, të pikës 1, të këtij neni.*
 - 3. Qenia anëtar i Autoritetit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore apo private.”*

Neni 19

Neni 14 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 14 - Zgjedhja e anëtarëve të Autoritetit

- 1. Kuvendi i Shqipërisë, jo më vonë se tre muaj, përpara përfundimit të mandatit të anëtarëve të Autoritetit publikon shpalljen për zgjedhjen e tyre.*
- 2. Kandidatët dërgojnë në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën dhe të Drejtat e Njeriut dokumentacionin e kandidimit për anëtar të Autoritetit, sipas parashikimeve të nenit 12 të këtij ligji.*
- 3. Komisioni brenda 20 ditësh verifikon plotësimin e kritereve për çdo kandidaturë dhe i përcjell ato për votim në Kuvend.*
- 4. Kuvendi në seancën e parë pas përcjelljes së kandidaturave nga Komisioni zgjedh me shumicë të të cilësuar prej tre të pestave të të gjithë deputetëve anëtarët e Autoritetit.”*

Neni 20

Neni 16 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 16 - Kompetencat e Kryetarit të Autoritetit

1. Kryetari ka këto kompetenca:

- a) vendos për rendin e ditës, thërret dhe drejton mbledhjet e Autoritetit, kujdeset për mbarëvajtjen e veprimtarisë së mbledhjeve të Autoritetit duke siguruar edhe dokumentimin e tyre, ndërmjet të tjerave me anë të regjistrimit audio;*
- b) në çdo fillim viti përgatit dhe propozon për miratim, jo më vonë se muaji janar, listën e subjekteve që duhen kontrolluar si dhe shortimin e tyre për çdo inspektor.*
- c) kujdeset për zbardhjen, publikimin, si dhe zbatimin e vendimeve të Autoritetit;*
- ç) përfaqëson Autoritetin në marrëdhënie me të tretët;*
- d) siguron bashkëpunimin institucional të Autoritetit me institucionet vendase dhe të huaja, si dhe në projekte, nisma rajonale, ndërkombëtare, në përputhje me qëllimin e veprimtarisë së Autoritetit;*
- dh) kujdeset për publikimin e veprimtarisë së institucionit në faqen zyrtare apo mjete të tjera komunikimi me publikun;*
- e) propozon kërkesat e Autoritetit për nevoja buxhetore dhe personel apo ndryshime legjislativë në organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi;*
- ë) kryeson grupet e punës për nevoja të ndryshme të Autoritetit, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji;*
- f) në ushtrim të kompetencave të veta nxjerr urdhra në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.”*

Neni 21

Në nenin 25/1 pika 1 riformulohet sipas përmbajtjes së që vijon:

“1. Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë kryhet:

- a. çdo vit për Presidentin e Republikës, deputetët, Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, ministrin, zëvendësministrin, gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Drejtuesin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokatin e Popullit, anëtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarin e organeve rregullatore ose të mbrojtjes së konkurrencës, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj dhe kryetarët e partive politike;*
- b. çdo 2 vjet për zyrtarët e tjerë të papërfshirë në shkronjën a.”*

Neni 22

Pas KREUT III shtohet KREU III/1 me këtë përmbajtje

KREU III/1 KONTROLLI I FIGURËS

Neni 39/1

Objekti i kontrollit të figurës

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Neni 39/2

Fillimi i procedurës për kontrollin e figurës

1. Subjekti në funksion plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës bashkëngjitur këtij ligji, brenda muajit mars të çdo viti dhe e dërgon atë pranë Autoritetit.
2. Autoriteti fillon menjëherë procedurën e kontrollit të figurës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
3. Subjekti që është kandidat për funksion, paraqet kërkesë me shkrim drejtuar Autoritetit, për kontrollin e figurës, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kandidaturës. Kërkesa i bashkëlidhet formularit për deklarinimin e kontrollit të figurës, sipas shtojcës së këtij ligji.
4. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën veprë penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal

Neni 39/3

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

1. Autoriteti për verifikimin e rrethanave që lidhen me figurën kërkon raportim nga gjykata, prokuroria, byroja kombëtare e hetimit, policia e shtetit, shërbimet shtetërore informative dhe çdo organ tjetër që ka në kompetencë administrimin e të dhënave të nevojshme.

2. Autoriteti ka të drejtë të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar për qëllim të këtij ligji.

Neni 39/4

Rrethanat që kontrollohen

Autoriteti, gjatë procedurave të kontrollit të figurës, duhet t'u përmbahet kërkesave të përgjithshme si më poshtë:

- a) verifikimi i saktë i identitetit në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo subjekt;
- b) verifikimi nëse ka tendencë kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar;
- c) vlerësimi i përgjithshëm, nëse subjekti është vënë nën presion nga strukturakriminale;
- ç) kontrolli nëse ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, nëbashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale;

Neni 39/5

Standardet e kontrollit të figurës

1. Kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme.

2. Kontrolli i figurës zhvillohet në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, armiqësor dhe miqësor, të cilat mund të favorizojnë ose disfavorizojnë subjektin.

3. Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë.

4. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur:

a) subjekti është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

b) subjekti ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

c) subjekti ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

ç) subjekti ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

d) subjekti merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.

5. Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar janë kur:

a) subjekti në mënyrë të besueshme parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara sipas pikës 4, të këtij neni;

b) marrëdhënia familjare e subjektit me personin e përfshirë në krimin e organizuar është e largët, ose ka kontakte familjare të rralla;

c) subjekti ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet dhe është distancuar prej tyre. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me kohëzgjatjen e kontakteve ose me perceptimin e arsyeve të veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit;

ç) subjekti ka qenë në dijeni që personi është i përfshirë në krimin e organizuar, por nuk ka qenë në dijeni të faktit se ai do të ishte i pranishëm në një takim, ose është mashtruar për një takim të tillë. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

d) kontaktet e subjektit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

dh) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila parashtrrohet në mënyrë të besueshme nga subjekti.

6. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm janë kur:

a) subjekti nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme;

b) subjekti nuk rendit në listë një kontakt, i cili përforcohet ose konsiderohet i besueshëm nga informacione të shërbimeve të fshehta dhe të besueshme;

c) subjekti nuk rendit në listë një kontakt që konstatohet nga informacioni përkatës i besueshëm dhe nga prova të tjera; në rast se subjekti ka kontakte të tjera që janë renditur ose konstatuar sipas këtij paragrafi; në rast se ka prova të tjera për një përfitim, veprim ose pasojë nga kontakti që krijon një dyshim të arsyeshëm se informacioni i marrë është shpjegimi i vetëm i mundshëm.

7. Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin, sipas të cilit formulari i deklarimit nuk është përfunduar plotësisht dhe me besueshmëri janë:

a) subjekti rendit në listë një kontakt, por data ose vendndodhja nuk është e saktë dhe kjo duket se është thjesht gabim ose ngatërresë;

b) subjekti nuk rendit në listë një kontakt, por ka qenë i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet e tjera dhe kjo mospërfshirje është thjesht gabim ose ngatërresë;

c) kontakti ka ndodhur në një vend me shumë njerëz dhe është i besueshëm fakti se kontakti nuk

mund të mbahej mend ose mund të mendohej i parëndësishëm. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontaktit ose me faktorë të tjerë, sipas këtij paragrafi;

ç) subjekti nuk rendit në listë një kontakt që ka të bëjë me një anëtar të familjes kur rrethanat e atij kontakti nuk mund të mbaheshin mend ose nuk ishin të rëndësishme. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontaktit ose me faktorë të tjerë, sipas këtij neni;

d) subjekti në mënyrë të besueshme parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara sipas pikës 6 të këtij neni;

dh) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila parashtrrohet në mënyrë të besueshme nga subjekti.

Neni 39/6

Procedura për kontrollin e figurës

1. Autoriteti, brenda 60 ditëve nga depozitimi i deklaramit, verifikon nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të afatit 60-ditor, Inspektori i Përgjithshëm mund të vendosë një zgjatje 30-ditore të afatit të verifikimit, në rast se është kërkuar informacion nga shtete të tjera.

2. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit, Autoriteti harton raportin që përcakton nëse subjekti ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklaramin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me rrethanat e figurës së papërshtatshme për funksionin. Ky raport përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 39/5 të këtij ligji. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër.

Neni 39/7

Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime

Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaramet nuk janë të sakta ose ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme, Inspektorati për Deklarimin dhe Kontrollin e Integritetit thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Neni 39/4

Përfundimi i kontrollit të figurës

1. Në përfundim të procesit të kontrollit të figurës Autoriteti vendos:

a) Konstatimin e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme.

b) Mungesën e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme.

2. Kur Autoriteti konstaton ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit me krimin e organizuar, atëherë vlerësohet se subjekti ka figurë të papërshtatshme, vlerësim i cili përbën shkak për humbjen e funksionit. Autoriteti njofton menjëherë organin e emërtesës për të proceduar sipas ligjit dhe nëse është rasti, edhe prokurorisë”

Neni 19

Dispozita Kalimtare

Jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji Kuvendi publikon shpalljen për zgjedhjen e anëtarëve të Autoritetit. Mandati i Inspektorit të Përgjithshëm ndërpritet me zgjedhjen e anëtarëve të Autoritetit. Autoriteti jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhje e tij miraton procedurat dhe metodologjinë për kontrollin e figurës.

Personat që mbartin detyrimin për plotësimin e formularit për deklarimin e kontakteve të papërshtatshme dorëzojnë formularin në Autoritet brenda 150 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARJA

Lindita NIKOLLA

ISHAQIPTARIA.COM